



UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI"
VLORE
ZYKA PROTOKOLL-ADMINISTRATIVE
Nr. 1813/10 Prot.
Datë: 05. 11. 2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. _____ Prot.

Vlorë më, 29. 10. 2020

VENDIM

Nr. 50, datë 29. 10. 2020

PËR
MIRATIM KRITERE DHE PROCEDURA PËR POZICIONIN E PUNËS
MAGAZINIER

Në mbështetje të nenit 49, të Ligjit Nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenit 25 pika 1 shkronja ë, nenit 52 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, shkresës së Administratorit nr. 1016 prot, datë 02. 07. 2020, në mbledhjen e datës 29. 10. 2020 Bordi i Administrimit,

VENDOSI

1. Të miratojë propozimin për kriteret dhe procedurat për pozicionin e punës "Magaznier", sipas shkresës nr. 1016 prot, datë 02. 07. 2020 bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi duke marrë parasysh sugjerimet e lëna nga Bordi i Administrimit :
 - Pika kriteret të veçanta "*Të këtë mbaruar arsimin e mesëm*", të ndryshohet në "*Të këtë minimumi arsimin e mesëm*".
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtoria e Komunikimit dhe e Burimeve Njerëzore në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Dr. Ervis MOCKA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR

Nr. 1016..... Prot.

Vlorë më, 02 . 07 .2020

Lënda : Propozim kriteret dhe procedurat për pozicionin e punës "Magaznier"

BORDIT TË ADMINISTRIMIT
KRYETAR DR.ERVIS MOÇKA

Në zbatim të Ligjit 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" ;Statutit të Institucionit ,me lejoni që me anë të kësaj shkrese t'ju përcjellë propozimin e Administratorit për kriteret dhe procedurat për për pozicionin e punës "Magaznier" pranë Sektorit të Financës në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse .

Bashkalidhur :Draft propozimi Administratorit

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin!





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR

- Bën raportime ditore tek eprori i drejtpërdrejtë
- Është përgjegjës të performojë detyra të tjera që kërkohen nga eprori i drejtpërdrejtë

KRITERET E VEÇANTA

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Te jetë shtetas shqiptar
- Të ketë mbaruar arsimin e mesëm
- Të ketë aftësi të mira kompjuterike , njohja e programeve bazë si dhe të përdorë programin financiar” Alpha buxhetor “
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës;
- Të ketë aftësi shumë të mira komunikuese , bashkëpunuese dhe raportuese;
- Të ketë eksperiencë pune mbi 3(tre) vite

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë ku ndodhet pozicioni për të cilin ata dëshirojnë të aplikojnë, dokumentet si më poshtë:

- Kërkesë për këtë pozicion;
- Jetëshkrim;
- Kopje të noterizuar të diplomës dhe të Listës së notave
- Kopje të noterizuar të diplomës/ve Master dhe të Listës së notave
- Kopje të librezës së punës;
- Fotokopje të kartës së identitetit ID;
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore ,lëshuar nga Gjykata dhe Prokuroria
- Referenca nga punëdhënësi të mëparshëm, në lidhje me eksperiencën në punë/jo skualifikues;
- Dëshmi të noterizuara të Kualifikimeve;
- Dëshmi të noterizuara të njohjes së gjuhës së huaj dhe përdorimit të kompjuterit
- Deklaratë e kandidatit për mos pasjen e konfliktit të interesit dhe nepotizëm me personelin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë;
- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj
- Aplikantët të cilët i dorëzojnë dokumentat të pa noterizuara ose kanë mangësi në dokumentacion skualifikohen menjëherë dhe nuk i nënshtrohen fazës së dytë.

Dokumentet duhet të dorëzohen vetëm nëpërmjet shërbimit postar në adresën;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
ADMINISTRATOR

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, Zyra e Protokollit, me shënimin "Për procedurën e konkurrimit për specialist prokurimesh inxhinjer të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë.

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Sektori i menaxhimit të burimeve njerëzore ,do të njoftoj kandidatët që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet intervista.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë mbi ligjin nr.80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";
- Udhëzimin nr 30 datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik" ;II "Menaxhimi I riskut të lidhur me aktivet"
- Njohuritë mbi të ligjit nr. 7961, datë 12/07/1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar;
- Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike".
- Njohuri mbi ligjin nr. 8503, datë 30.06.1999, "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare", i ndryshuar.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen **me sistem pikëzimi**, për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe certifikatat që vërtetojnë aftësinë, cilësi si dhe përvojë e tyre. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmërinë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

ADMINISTRATOR
MIRELA DUKA